REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. ____ prot., Tiranë ___.___.2026

V E N D I M

Nr. 23 datë 29.10.2026

PËR

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRMBLEDHËS TË VLERËSIMIT "MBI PËRMBUSHJEN E TË GJITHA KUSHTEVE TË PËRDORIMIT TË FREKUENCAVE TË BREZAVE 2100 MHZ (2X10 MHZ, FDD), NGA SIPËRMARRËSI "ONE ALBANIA" SH.A, SHOQËRUAR ME PROPOZIMIN PËR ÇMIMIN REFERENCË MINIMAL PËR RINOVIMIN E AUTORIZIMIT INDIVIDUAL"

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	**Gentian Sala**	**Kryetar**
Znj.	**Edlira Dvorani**	**Dvorani**
Z.	**Armer Juka**	**Anëtar**
Z.	**Bleron Dokle**	**Anëtar**
Znj.	**Diana Dervishi**	**Anëtar**

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 29.10.2026, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" dhe Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)" miratuar me vendimin nr.11, datë 31.03.2026, të Këshillit Drejtues të AKEP me propozim të Grupit të Punës shqyrtoi çështjen me objekt:

- "Miratimin e "Raportit Përmbledhës të Vlerësimit "Mbi përmbushjen e kushteve për përdorimin e frekuencave 2100 MHz (2 x 10 MHz, FDD) të sipërmarrësit "One Albania" sh.a., të shoqëruar me propozimin për çmimin referencë minimal për rinovimin e autorizimit individual."

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 69 dhe 70 të ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë";
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 496, datë 22.07.2014 "Për miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të Autorizimeve Individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim";
3. Plani Kombëtar i Frekuencave, miratuar me VKM nr. 756, datë 13.12.2024;
4. Autorizimi Individual miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 10, datë 12.10.2023 "Për ndryshimin e VKD nr. 3, datë 25.05.2023 "Për pajisjen me Autorizime Individuale të sipërmarrësit One Albania sh.a., për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit eficent të këtyre frekuencave"" (me nr. 73/78 prot, datë 12.10.2023 për përdorimin e 2 x 10 MHz në brezin e frekuencave 1900/2100 MHz), me afat vlefshmërie deri më 30.10.2026.
5. Aneksi 5 "Kushtet e përgjithshme dhe specifike për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike", të Rregullores "Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm", miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të AKEP, nr. 10 datë 31.03.2026;
6. Nenin 6 i Rregullores nr. 30, datë 05.12.2013, "Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave".
7. Urdhrin nr. 183, datë 16.09.2026, të Kryetarit të KD së AKEP, "Për ngritjen e Grupit të Punës për vlerësimin e përmbushjes së të gjitha kushteve të përdorimit të frekuencave të brezit 2100 MHz, për sasinë e spektrit 2 x 10 MHz (FDD), nga sipërmarrësi "One Albania" sh.a.

KËSHILLI DREJTUES:

Pasi shqyrtoi materialin shkresor të përbërë nga:

1. Shkresa nr. 1320 prot, datë 09.07.2026, e sipërmarrësit "One Albania" sh.a., me objekt "Mbi rinovimin e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave në brezin 1900/2100 MHz", (2x10 MHz FDD)", protokolluar në AKEP me nr. 1614 prot., datë 09.07.2026;
2. Relacioni shoqërues i projektvendimit
3. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
4. Raporti Përmbledhës i Vlerësimit, i përgatitur nga Grupi i Punës, mbi përmbushjen e të gjitha kushteve të përdorimit të frekuencave 2100 MHz (2 x 10 MHz, FDD) nga sipërmarrësi "One Albania" sh.a., i shoqëruar me propozimin për çmimin minimal referencë për rinovimin e Autorizimit Individual;

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Sipërmarrësi "One Albania" sh.a., disponon Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave në brezin 1900/2100 MHz miratuar me VKD nr. 3, datë 25.05.2023, "Për pajisjen me Autorizime Individuale të sipërmarrësit One Albania sh.a., për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit eficient të këtyre frekuencave", të ndryshuar me vendimin nr. 10, datë 12.10.2023, të KD të AKEP. Referuar këtij vendimi, sipërmarrësi "One Albania" sh.a. disponon Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave të brezit 2100 MHz, për sasinë e spektrit objekt të këtij vlerësimi, konkretisht 2x10 MHz (FDD), me afat vlefshmërie deri më 30.10.2026.
2. Me shkresën nr. 1320 prot., datë 09.07.2026, administruar në AKEP me nr. 1614 prot., datë 09.07.2026, sipërmarrësi "One Albania" sh.a., ka paraqitur kërkesë për rinovimin e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave në brezin 1900/2100 MHz, në sasinë 2 x 10 MHz FDD dhe nuk ka shprehur interes për sasinë e spektrit 5 MHz (TDD) në brezin 2100 MHz, dhënë me të njëjtin autorizim (me afat vlefshmërie 30.10.2026).
3. Bashkëlidhur kësaj shkrese, sipërmarrësi "One Albania" sh.a., ka paraqitur informacionin si më poshtë:

- Kushtet mbi mbulimin me shërbime;
- Mbulimi me shërbime në bandën 2100 MHz në rrugët kombëtare;
- Përmbushja e kushteve dhe detyrimeve sipas Anekseve të Autorizimit 73/78;
- Investimet e kryera;
- Kushtet dhe rrethanat kombëtare të tregut celular;
- Ecuria dhe treguesit në tregun celular për shërbimet bazë të zërit dhe SMS-ve;
- Investimet në bandën 3.5-3.8 GHz;
- Përdorimi efektiv i frekuencave;
- Vlerësimi analitik i shoqërisë ONE Albania mbi çmimin minimal për rinovimin e Autorizimit Individual për 2x10 MHz në bandën 2100 MHz.

4. Mbështetur në nenet 69, 70 e në vijim të Kreut IX – Qasja në Spektrin e Radiofrekuencave të ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", pikën 8 të nenit 191 të ligjit nr. 54/2024, që përcakton se: "*Aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, mbeten në fuqi edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, kur nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji deri në miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji"*, VKM Nr. 496, datë 22.07.2014 për "Miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim", Kryetari i AKEP, me Urdhrin nr. 183, datë 16.09.2026 (shkresa nr. 1614/1 prot., datë 16.09.2026), ka ngritur Grupin e Punës për vlerësimin e përmbushjes së të gjitha kushteve të përdorimit të frekuencave të brezit 2100 MHz, për sasinë e spektrit 2 x 10 MHz (FDD), nga sipërmarrësi "One Albania" sh.a.

5. Në zbatim të Urdhrit nr. 183/2026, Grupi i Punës, në përputhje me procedurën e përcaktuar në Kreun II të VKM-së nr. 496/2014, dhe mbi bazën e informacionit dhe dokumentacionit të administruar për këtë qëllim, ka kryer vlerësimin e përmbushjes së të gjitha kushteve të përdorimit të frekuencave të brezit 2100 MHz sipas Autorizimit Individual dhe Autorizimit të Përgjithshëm si dhe të dhënave të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të Kreut II të VKM nr. 496/2014, duke nxjerrë në përfundim të procesit, Raportin Përmbledhës të Vlerësimit mbi përmbushjen nga sipërmarrësi "One Albania" sh.a., të të gjitha kushteve sipas Autorizimit Individual dhe atij të Përgjithshëm, për përdorimin e frekuencave 2100 MHz, të shoqëruar me propozimin mbi çmimin referencë minimal për rinovimin e Autorizimit Individual

6. Në përfundim të procedurës së vlerësimit, të materializuar në Raportin Përmbledhës të Vlerësimit, arrihet në konkluzionin se: *Sipërmarrësi "One Albania" sh.a. përmbush kushtet e përcaktuara në Autorizimin Individual dhe Autorizimin e Përgjithshëm lidhur me përdorimin e frekuencave të brezit 2100 MHz, për sasi spektri 2 x 10 MHz (FDD), në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, dhe nuk rezulton në kushtet e refuzimit të rinovimit të Autorizimit Individual.*

Në vijim, nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar, të dhënave të raportuara, monitorimeve dhe verifikimeve të kryera nga AKEP, rezulton se sipërmarrësi "One Albania" sh.a. ka përmbushur kushtet dhe detyrimet lidhur me:

a. Mbulimin e territorit dhe popullsisë me shërbim;
b. Zbatimin e kushteve teknike të funksionimit, të nevojshme për shmangien e interferencave të dëmshme dhe kufizimin e ekspozimit të publikut ndaj fushave elektromagnetike;
c. Përdorimin dhe shfrytëzimin efektiv të frekuencave në përputhje me rregullat dhe standardet e përcaktuara, si dhe afatin e vlefshmërisë së përdorimit;
d. Cilësinë e shërbimit/ve dhe tarifat për shërbimet e ofruara nëpërmjet rrjetit që operon, sipas rregulloreve përkatëse të nxjerra nga AKEP;
e. Kryerjen e pagesave;
f. Transferimin e të drejtave të pronësisë për përdorimin e frekuencave dhe kushtet për këtë transferim;
g. Detyrime për aktet dhe marrëveshjet ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë;
h. Detyrime të tjera, të marra përsipër nga sipërmarrësi gjatë pjesëmarrjes në tenderin/konkurrimin publik.

7. Për llogaritjen e çmimit referencë minimal, Grupi i Punës ka marrë në konsideratë këta faktorë:
   - Praktika të ngjashme të zbatuara në vende të tjera (rajon dhe në vendet e BE-së)
   - Vlerat e pagesave (one-off) që kanë rezultuar në proceset e mëparshme të alokimit të frekuencave në Shqipëri në brezin 2100 MHz, si dhe në breza të tjerë të dhënë në përdorim të operatorëve celularë;
   - Vlera e propozuar nga One Albania (mendimi paraparak i palës së interesuar).

- Faktorë të tjerë që ndikojnë në përcaktimin e vlerës/çmimit minimal si rrethanat e tregut, zhvillimi i konkurrencës, interesi publik etj.;

8. Si përfundim, propozimi për çmimin minimal referencë për rinovimin e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave frekuencave 2100 MHz (2 x 10 MHz, FDD) të sipërmarrësit "One Albania" sh.a., bazohet në kritere dhe metodologji që merr në konsideratë zhvillimin e konkurrencës, interesin publik dhe mbrojtjen e konsumatorit, në rrethanat e tregut dhe përdorimin efektiv të frekuencave si dhe mendimin paraprak të sipërmarrësit si palë e interesuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr.54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë dokumentin "Raport Përmbledhës për vlerësimin e përmbushjes së kushteve të përdorimit të Autorizimit Individual të sipërmarrësit "One Albania" sh.a., shoqëruar me propozimin për çmimin minimal referencë për rinovimin e Autorizimit Individual".
2. T'i paraqesë Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, dokumentin e miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, duke i propozuar vijimin e procedurës sipas Kreut III të VKM nr. 496/2014.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	**Anëtar**	**Anëtar**	**Anëtar**	**Anëtar**
Gentian Sala	**Edlira Dvorani**	**Armer Juka**	**Bleron Dokle**	**Diana Dervishi**